

Infektive - virusale



Herpes Simplex (Ethet e ftohjes/buzëve)

Njoftime Të Rëndësishme

- Herpesi i buzëve është një infektim i zakonshëm viral që paraqitet me fazë primare infektive dhe fazë sekundare infektive që kohë pas kohe mund të përsëritet
- Infektimi primar mund mos të vërehet, por mund të zhvillohet në ulcerë gojorë që dhëmbin, gjandrat qafore bëhen të ndjeshme dhe fëmitë i zënë ethet
- Infektimi sekundar, ose i përsëritur njihet si 'ethe ftohjes' dhe shpesh përsëritet në të njëjtin vend me sulme që zgjasin 2-5 ditë
- Urgjentisht duhet kërkuar këshillë mjeksore për fëmijë me ekzemë që zhvillojnë infektim të lëkurës të tipit 'Herpes simplex'
- Pjesa dërmuese e infektiveve primare të tipit 'herpes simplex' nuk lyp trajtim antiviral
- Përdorimi i mjeteve mbrojtëse ndaj diellit është me rëndësi për parandalimin e sulmeve të përsëritura të 'etheve të ftohjes' në fytyrë
- Kremat antivirale dhe losionet për 'ethet e ftohjes' (herpes simplex) mund të blehen, por patjetër duhet të përdoren mbrenda orëve të herëshme të nisjes të infektimit
- Infektimi sekundar bakterial i 'etheve të ftohjes' është i zakonshëm dhe duhet përdorë kremë antiseptik dhe tretje për ta parandaluar infektimin

Ç'është 'Herpes Simplex'?

Herpes simplex është infektim i zakonshëm viral që shkakton pezmatim dhe fshika (fluska) në pjesë të limituara të lëkurës. Infektimi i parë (primar) shpesh zhvillohet në fëmijëri. Zakonisht infektimi i vazhdueshëm përsëritet kohë pas kohe gjatë viteve dhe paraqitet me të ajur, skuqje dhe formim fluskash zakonisht në buzë dhe rreth gojës.

Infektimi primar mund të mos vërehet. Ndonjëherë mund të jetë më i ashpër duke shkaktuar ulcerë gojorë që dhëmbin dhe zmadhim dhe ndjeshmëri të gjandrave në qafë. Te fëmijët me ekzemë, infektimi 'herpes simplex' pran ekzemes mund të shkaktoj përhapjen e fluskave me ç'rast fëmiun duhet urgjentisht ta dërgoni në vizitë mjeksore.

Infektimi më i zakonshëm që përsëritet, ose 'ethet e gojës' mund të zhvillohet prej etheve, ekspozimit në dritë të diellit ose në frymë, ose ndonjëherë prej stresimit. Ato nisin me mizërim ose djegëje, përcillen me pezmatim (me ngjyra prej të kuqes në të purpurët dhe ngjyrë kafe) dhe me formim të fluskave. E

Albanian – Herpes Simplex (Cold Sores)

gjithë kjo zhvillohet mbrenda 24-48 orëve dhe merr 4-5 ditë gjersa të pastrohet. Infektimi sekondar bakterial mund të zhvillohet në ethet e gojës.

Si mundë të parandalohet?

Mbase 'herpesi' lehtë transmetohet personat me' ethe aktive në buzë duhet të evitojnë kontaktet direkte me lëkurë me persona të tjerë, p.sh. puthjet.

Përdorimi i mjeteve mbrojtëse ndaj diellit, siç janë rrobat, kapela dhe kremat mbrojtëse është i rëndësishëm në parandalimin e sulmeve të përsëritura të 'herpesit në gojë' / fytyrë.

Si trajtohet?

Ndonjë tretman antiviral zakonisht nuk përdoret për infektimin primar të 'Herpesit gojor' .Nëse te fëmijët paraqiten ulcerë gojorë, atyre duhet dhënë fluide me bollëk dhe ushqime të buta. Nëse fluskat ose ulcerët shkaktojnë dhëmbje ose nëse fëmiu është në ethe, e vetmja gjë e nevojshme është dhënja e ilaçeve të buta kundër dhimbjes, siç është, 'paracetamol.

Për 'herpes gojor' egzistojnë shumë krema dhe losione. Megjithatë nuk ka kurim për këto sulme të vazhduara.

Fatmirësisht, sulmet sa shkojnë dhe rrallohen dhe me kohë dobësohen. Produkti specifik antiviral i dhënë prej farmacistit patjetër duhet të përdoret mbrenda orëve të para që të parandalohet zhvillimi i infektimit bakterial në 'herpesin gojor'.

Për informata të Mëtejme

Infermijerja e juaj e Qendrës Për Shëndetin e Nënës dhe Fëmiut
Farmacisti i juaj
Mjeku i juaj i familjes
Dermatologu

© 2002, Department of Dermatology, St. Vincent's Hospital Melbourne, Victoria Parade, Fitzroy, Victoria 3065 Australia.